



TEL: +38649510007 dhe +37744364106

e mail: kosovajudo@hotmail.com

RAPORT

Seminari per Antidoping

16 Shkurt 2019

Peje, Kosove

Ne palestren e xhudos “Ippon” ne Peje u mbajt seminari per Anti Doping.

Ky seminar u udhehoq nga xhudistja Nora Gjakova.

Pjesemarres ishin trajneret, xhudistet elitare si dhe xhudiste te grupmoshes U21 dhe U18 qe kane marr pjese ne gara te ndryshme nderkombetare.

Ky seminar u mbajt me qellim te ndergjegjesimit si dhe njoftimit te xhudisteve dhe trajnereve rreth procedurave dhe Kodit te Anti Dopingut te Wada-se, Federates Boterore te Anti Dopingut.

Gjakova se bashku me disa xhudiste te tjere pjesemarres ne gara zyrtare te EJU dhe IJF me dhjetra here iu jane nenshtruar procedurave te dopingut ne gara apo gjate pergaditjeve si dhe se fundmi edhe gjate stervitjeve ne qendren Ippon ne Peje, me urdher te Federates Boterore te xhudos.

Momentalisht nga Federata jone jane 4 xhudiste (Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, Akil Gjakova, Distria Krasniqi) te perzgjedhur nga Federata Boterore e xhudos dhe WADA per te raportuar vendndodhjen ne sistemin ADAMS.

Xhudistet e perzgjedhur nga IJF dhe WADA u njoftuan edhe per bashkepunimin e fundit te IJF me ITA (International Testing Agency) Agjensine nderkombetare te testimit e cila do ta drejtoje programin e IJF per testim jashte garave e qe perfshin kontrollimin e rregullt te vendndodhjeve te sportisteve, si dhe trajtimin e menaxhimin e rezultateve te rasteve pozitive.

Si pjese e programit te Anti Dopingut-Rruga e paster drejt Tokyos (Clean Road to Tokyo) te IJF-se(Federates Boterore te xhudos) bashkepunimi IJF-ITA do te zgjerohet per te testuar te gjithë sportistet qe jane potencialisht te kualifikuar ne Lojerat Olimpike ne Tokyo,duke i testuar te pakten nje here ne vitin 2019 dhe 2020.

Gjate ketij Seminari u diskutuan shume ceshtje te rendesishme rreth Anti Dopingut sikur:

Lista e substancave dhe metodave te ndaluara ne gara dhe jashte garave,vetem ne gara dhe per sporte specifike

Perjashtimet per perdorime terapeutike-Ne rast te perdorimit te substancave apo metodave qe jane te listuara si te ndaluara nga WADA

IJF Registered Testing Pool (RTP)- Perzgjedhja nga IJF (Federata Boterore e xhudos) per te raportuar permes sistemit ADAMS vendndodhjen gjate nje viti ADAMS System-Njoftimi me menyren e perdorimit te sistemit ADAMS si dhe rendesia e plotesimit te vendndodhjes se sakte gjate tere vitit

Kontrolla e Dopingut-Procedurat

Nder te tjera u diskutua edhe rreth perdorimit te disa ilaqeve te cilat pa ndonje kufizim mund te blihen ne farmaci por mund te permbajne substanca te ndaluara nga WADA.

Nje prej shembujve te shumte qe u diskutua ishte pluhuri Tylool Hot (qe zakonisht blihet kunder gripit) qe permban substancen pseudoephedrine te ndaluar nga WADA gjate dhe jashte garave.

U kerkua nga te gjithë sportistet qe te kene kujdes gjate perdorimit apo blerjes te cfaredo medikamenti,fillimisht duke u konsultuar me farmacistin nese eshte ne listen e substancave te ndaluara apo edhe duke e shikuar listen zyrtare te WADA-se per Anti-Doping. Ne shtetet perendimore secila farmaci permban listen e substancave te cilat mund te permbajne Doping por e njejta nuk vlen ne Kosove sepse farmacite nuk permbajne informacione te duhura rreth ceshtjes se dopingut.

Seminari perfundoj me sukses dhe te gjithë pjesemarresit u njoftuan hollesisht me kodin e Anti-Dopingut.

